

RRUGA E PARTISË

**ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË**

Adresa :

**»RRUGA E PARTISË«
pranë KQ të PPSH – Tiranë**

Pajtimet:

për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë

Jashië shtetit:

për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

Nëntor 1979

Viti XXVI i botimit

Përmbytja:

ENVER HOXHA — Dëshmi e fuqishme e vijës së drejtë të Partisë, e forcës së pathyeshme të popullit, e vitalitetit të rendit socialist (Fjala e mbajtur në mitingun e madh në Bahçellëk të Shkodrës më 19 tetor 1979) 5

35 VJET SHQIPERI SOCIALISTE

F. ISLAMI — N. HOXHA — Industrializimi socialist — domosdoshmëri për zhvillimin e pandërpërë e të pavarur në rrugën e socializmit 14
A. BACKA — Politikë klasore revolucionare përgushtimin e dallimeve thelbësore ndërmjet fshatit e qytetit 26
H. BANJA — Arritje dhe perspektiva të shkencave ekonomike 38
L. ZHAMO — Garanci për arritje të reja të shkollës sonë të revolucionarizuar 40
L. LEKA — Ta çojmë më tej revolucionin e realizuuar në jetën e gruas shqiptare 58
A. KAZANXHI — Monumentet e kulturës — thesar i madh me vlera aktuale 68

MATERIALE NGA PUNA E KOMITETEVE TË PARTISË

— Të jetojmë me situatat dhe të përbushim detyrat lidhur ngushtë me to 77

ENVER HOXHA

DËSHMI E FUQISHME E VIJËS SË DREJTË TË PARTISË, E FORÇËS SË PATHYESHME TË POPULLIT, E VITALITETIT TË RENDIT SOCIALIST

- Fjala e mbajtur në mitingun e madh
në Bahçellëk të Shkodrës më 19 tetor 1979 -

Të dashur shokë e shoqe, motra e vëllezër të rrëthit të Shkodrës e
të gjithë Shqipërisë,

Përfundimi me sukses të plotë i të gjitha ndërtimeve në rrëthet e Shkodrës, Lezhës, Mirditës, Dibrës, Krujës, Matit, Pukës e Tropojës, që u dëmtuan rëndë nga tërmeti i fortë i 15 prillit të këtij viti, është për të gjithë popullin, për Partinë dhe për mua një gjëzim i papërshtkuar. Në asnjë vend të botës nuk ka ndodhur që pasojat e një fatkeqësie të madhe si kjo të zhduken brenda një kohe rekord siç ndodhi në vendin tonë socialist.

Tërmetet janë një fenomen natyror që njihen shikencërisht, por pasojat e tyre nuk mund të parandalohen. Një numër zonash të globit tokësor, për shkaqe që dihen, preken nga lëkundje të mëdha ose të vogla.

Vendi ynë nuk përfshihet në zonat e vecanta të tërmeteve, por kjo nuk e përjashton atë nga lëkundjet e tyre. Faktet historike tregojnë se në çdo kohë kanë ndodhur tërmete që janë ndierë dhe kanë shkaktuar dëme në vendin tonë, si edhe në vendet e tjera. Historia e lashtë flet sidomos për tërmetet e forta të Dyrrahiumit të vjetër, të Tepelenës, të Gjirokastrës etj.

Para Clirimit të Shqipërisë, në kohën e sundimit të pushtuesve të huaj dhe të feudo-borgjezisë vendëse, tërmetet përbënë një nga fatkeqësitë më të mëdha për popullin tonë, sepse ai ishte i varfër, i rraskapur dhe i shfrytëzuar në kulm nga pushtuesit e nga klasat sunduese dhe, si i tillë, nuk gjente as mundësinë më të vogël për të për-

balluar sado pak fatkeqësinë që i binte në kokë. Kur ndonjërit i rrëzohej shtëpia në të kaluarën, kjo përbënte një gjëmë të madhe pér të dhe pér familjen e tij. Me vështirësi të mëdha dhe dulke kursyer nga goja e vet dhe e fëmijëve kafshatën e bulkës, atij do t'i duheshin me dhjetëra vjet që të rindertonte çatinë sa pér të mbuluar kokén. Megjithatë, edhe në ato kohë aq të rënda e fatkeqe, kur sundimtarët nuk i jepnin as ndihmën më të vogël të démtuarit, nuk ka munguar ndihma e një rëzve tanë të thjeshtë pér shoku-shokun, e vëllait pér vëllanë, e mikur pér mikun, e shokut pér shokun. Përkrahja në fatkeqësi, me gjithë fukarallëkun e mjerimin e madh që ekzistonte në vend, ka qënë një ngvetitë karakteristike të popullit tonë. Dikush jepte një velenxë, dikus një jorgan, i treti një sahan a një lugë, tjetri ndihmonte me punën e tij pér të ngritur një kasolle me baltë a një haur sa pér t'u futur brendësuar.

Pas Clirimit, me fitoren e madhe historike të Luftës Nacionaçlirimtare, me marrjen e fuqisë nga populli, me vendosjen e shtetit të diktaturës së proletariatit, nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme të Punës, si në çdo drejtim tjetër, edhe në drejtim të fatkeqësive natyrore, sic janë tërmetet, gjëndja ndryshoi krejtësisht. Rrënimet nga tërmeti që preknin krahina të tëra dhe ishin nga më të rëndat, filluan të zhduken me vendosmëri të madhe pa shumë dhembje dhe brenda një kohe shumë të shkurtër. Tani për t'i ndihmuar të prekurit nga ndonjë fatkeqësi e për të zhdukur pasojat që sjell ajo, ngrihet në këmbë menjëherë gjithë populli, të cilit i bën thirrje Partia, ashtu sikurse edhe dje në Luftën Nacionaçlirimtare. Kur Partia i bëri thirrje popullit për clirimin e Atdheut, ai u ngrit i terti dhe iu përgjigj flakë për flakë kushtrimit të saj. Kështu ka ndodhur te ne edhe pas Clirimit kur kanë rënë tërmete, si ato në Dibër e Librazhd, në Tepelenë e në fshatrat e Mallakastrës, në Sarandë e gjetkë dhe tanë së fundi, në rrerhethet e Shkodrës, Lezhës dhe në qytete e në shumë fshatra të disa rretheve të Shqipërisë së Veriut. Mëbarë populli ynë, me thirrjen e Partisë dhe me besim të pakufishëm tek ajo, u ngrit menjëherë dhe si një trup i vetëm, u mobilizua për të përballuar dëmet e shkaktuarar për të lehtësuar e ndarë dhembjen e madhe së toku me vëllezërit e motrat e dëmtuar.

Më 15 prill të këtij viti tërmeti na vrau dhe na plagosim shumë vëllezër e motra, na preku 500 fshatra e disa qytete, ku dolën jashtë përdorimit më tepër se 17 mijë shtëpi, objekte ekonomike e socialkulturore dhe, si pasojë, rrëth 100 mijë banorë mbetën pa strehë. Pënjë qast u lëkund fort toka, u lëkundën kodrat, u lëkundën malet tonë shtëpi e fshatra të tëra na u rrafshuan përtokë, por nuk u lëkund shqiptari. Ai qëndroi fort në këmbë, ashtu siç ka qëndruar kurdoherë pënpara rrebesheve që e kanë kërcënuar, ashtu siç ka qëndruar kur amigotë janë përpjekur t'i prekin lirinë dhe kufijtë e Atdheut.

Shqiptari asnjëherë, në asnjë rrethanë, nuk është ligështuar, por me syrin në thepin e pushikës e ka mbajtur drejt shtatin, ka përvshur krahët, ka ngritur lart zemrën, ka vënë të gjitha forcat e tij fizike dhe mendore për të përballuar rreziqet. Mbi hirin, mbi rrënimet nga luftërat barbare të pushtuesve të ndryshëm, ai ka ditur të qëndroj

i paepur e të rindërtojë Atdheun. Edhe në kohët tona, me Luftën vigane Nacionaleçlirimtare kundër fashistëve italianë dhe nazistëve gjermanë, populli ynë e çlroi vendin dhe, pas kësaj lufte, e rindërtoi At-dheun e zhuriut nga armiqjtë. E rindërtoi atë shpejt dhe ashtu siq deshironte. Më vonë ndërtoi e po ndërton një shoqëri të vërtetë sociale, ku rrion i lirë, në demokraci dhe në sovranitet të plotë. Të bashkuar dhe në dashuri të papërshkruar jetojnë njerëzit tanë me njëri-tjetrin dhe me Partinë e pushtetin e tyre.

Ne jemi një vend i vogël dhe një popull i vogël. Por popullin shqiptar e karakterizojnë një forcë dhe një qëndrueshmëri e madhe, të pashembullta, për mbrojtjen e At�heut dhe për mbrojtjen e jetës së tij. Këtë forcë dhe qëndrueshmëri të popullit shqiptar i vërtetan kishte.

Ne jemi pasardhësit e fiseve ilire. Në këto troje të lashta të të parëve tanë kanë vërvshuar grekët, romakët, normandët, sillavët, anzhui-nët, bizantinët, venedikasit, osmanët e shumë e shumë pushtues të tjerë, por ata nuk i zhdukën dot as popullin shqiptar, as kulturën e vjetër ilire, as vazhdimësinë e saj shqiptare. Kjo tregon dashurinë e madhe të popullit tonë për jetën, tregon vendosmërinë shembullore të tij për të mbrojtur vatrën, kulturën, bashkimin dhe cdo gjë të shenjtë të kombit shqiptar.

Edhe në kohët e reja populli shqiptar ka pësuar shumë fatkeqësi. Atë u përpoqën ta zhduknin si popull e si komb dhe ta shpartallonin si një unitet të gjallë e veprues. Të huajt u përpoqën dhe e copëtuan vendin, ata u përpoqën t'ia zhduknin edhe zakonet, t'ia bastardonin edhe kulturën, edhe gjuhën, por më kot.

Në kohët moderne, më 7 prill të vitit 1939, populli dhe vendi ynë, i qeverisur nga një mbret xhelat feudal, armik e tradhtar, që e kishte shitur Shqipërinë tek Italia, u sulmua nga ushtria fashiste e Mussolini dhe më pas edhe nga ushtria e Hitlerit. Por populli dhe klasa punëtore e Shqipërisë nxorrën nga gjiri i tyre Partinë e lavdishme Komuniste, sot Partia e Punës e Shqipërisë, e cila, që në ditët e para të themelimit të saj, lëshoi kushtrimin: Në këmbë, o burra e gra të Shqipërisë, në këmbë i madh dhe i vogël, për të përballuar rrebeshet që na kanosen e për të dalë fitimtarë mbi armiqjtë! Dhe ne dolëm fitimtarë në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë, në sajë të luftës së lavdishme të popullit shqiptar, në sajë të patriotizmit të flaktë të bijve të këtij trualli bujar, në sajë të ideologjisë së pavdekshme të marksizëm-leni-nizmit.

Luftha na shkatérroi, ajo rrénoi gđo gjë, mijéra véllezér dhe motra na u vranë, por ne asnjéherë s'e humbëm kurajon. Nuk ishte populli ynë nga ata që qanin mbi fatkeqësitë, por ishtë një popull trim, që diti të luftojë e të fitojë dhe, pas fitores, të vazhdojë luftën përdërtimin e një shoqërie të re, të shoqërisë socialiste. Dhe ja, këtë shoqëri socialiste populli tanë e gézon, e jeton, e mbron dhe e zhvillon gjithnjë e më përparrë.

Sot, në sajë të vijës së drejtë të Partisë dhe të shtetit të diktaturës së proletariatit, Shqipëria është e popullit punonjës dhe askush nuk guxon ta prekë. Edhe një fatkeqësi kaq e madhe natyrore me pa-

soja të rënda si kjo e tërmetit të 15 prillit të këtij viti, që na rrafshoi përtokë krahina të tëra, nuk e ligështoi popullin tonë.

Motra dhe vëllezër,

Kurrë ndonjëherë në asnjë vend të botës, ku kanë rënë e bien tërmete, nuk është parë që, brenda pesë muajve, të ndërtohen aq shtëpi banimi sa të futet brenda një popullatë e barabartë me atë të dy qyteteve të mëdha siç janë Durrësi dhe Vlora të marra së bashku, pra të ristrehohen në shtëpi moderne, më të mira se ç'i kishin, afro 100 mijë banorë.

Në vende të tjera, ku sündojnë borgjezia dhe kapitali, tërmetet, përfat të keq, përbëjnë, siç mund ta keni dëgjuar, një fatkeqësi të tmerrshme, që u shkaktojnë të dëmtuarve plagë të rënda që nuk i shërojnë dot as përfshumë kohë.

Ka vende të prekura nga tërmetet ku njerëzit e dëmtuar kalojnë me dhjetëra e dhjetëra vjet në pritje përfshirë siguruar të paktën një kasolle, por as këtë nuk e sigurojnë dot. Ata rrojnë në kushte të rënda, në çadra, në llucë, në shi e në borë. Përfshirët e shtëpive të këtyre të mjeruarve bëhet gjithë ajo bujë, caktohen edhe shuma të mëdha të hollash, gjoja përfshirët e ndihmuar, por në fakt nuk bëhet gjë, sepse këto shuma në botën e kalbur kapitalisto-revizoniste vidhen e grabiten nga të gjithë ata që ngarkohen gjoja t'i drejtuan e t'i administrojnë këto fonde dhe nga gjithfarë matrapazësh e spekulatoresh.

Në vendet kapitaliste dhe revizioniste, kuq ngjasin të tilla fatekeqësi, qeveritë, në fuqi zgjatin duart e lypin nga të katër anët, ku të mundin e sa të mundin, përfshirë marrë ndihma në të holla, shtresa e mbulesa, veshmbathje, ilaqe e qdo gjë tjetër të nevojshme e, megjithëkëtë, të dëmtuarit e gjorë prapë mbeten në mjerim, në mes të katër rrugëve. Kurse vendi ynë socialist, ashtu siç i ka përballuar tërmetet e mëparshme, edhe pasojat e këtij tërmeti kaq shkatërrues, i zhduku me forcat e veta, pa i nderur dorën kurkujt, pa pranuar asnjë ndihmë, nga cilado anë që mund të vinte.

Shteti i diktaturës së proletariatit, shoqëria janë socialistë, me Partinë e Punës të Shqipërisë në krye, me mundësitet dhe me rezervat e tyre ekonomike të pashtershme, me forcat e shpirtit bujar të njerëzve të papërkulur, e mundëshme shpejt tërmetin, ndërtuan qdo gjë që u shkatërrua, shkolla, shtëpi kulture, çerdhe e kopshë fëmijësh, shtëpi lindjeje, rrugë, ujësjellës e shumë objekte të tjera të domosdoshme dhe ua dhuruan vëllezërvë e motrave të zonave që pësuan këtë fatkeqësi.

Familjet që u futën në shtëpitë e reja moderne janë sot në festë, janë të gëzuara e të lumturë, janë krenare përfshirë Partinë e tyre të dashur, përfshirët e tyre të fuqishëm.

Gjithë këto shtëpi të bukurë janë prona personale të familjeve që u strehuan në to, të cilave u urojmë që t'i gjëzojnë përmot e jetë. Shteti i proletarëve nuk do të marrë nga ata asnjë shpërbirim, asnjë takshë dhe asnjë qira. Ja, vëllezër dhe motra, shokë dhe miq, q'do të thotë socializëm, q'do të thotë diktaturë e proletariatit, q'do të thotë fitore e revolucionit socialist mbi armiq të kapitalistë, të jashtëm dhe të

brendshëm. Kjo është vija e Partisë sonë, që shpreh vullnetin dhe interesat e popullit e të Atdheut socialist. Këtë vijë të drejtë, që udhëhiqet nga doktrina kurdoherë fitimtare e marksizëm-leninizmit, komunistët shqiptarë, populli ynë, e pasurojnë, e zhvillojnë, e mbrojnë dhe e ruajnë të pastër si qelikari. Ja, ky është vitaliteti i rendit tonë shoqëror socialist, i forcës së madhe dhe i qëndrueshmërisë së ekonomisë sonë socialistë.

Borgjezia dhe revizionistët janë përpjekur përfshumë e shumë vjet me radhë të gjenjnjë botën duke i thënë të kundërtën e asaj që ka ndodhur në Shqipëri, ata janë orvatur ta bëjnë të bardhën të zezë dhe të mohojnë të gjitha ato që po realizohen në vendin tonë, të shpifin se gjithë këto realizime nuk po arrihen nga populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij e lavdishme e Punës, por nga të huajt. Qeveritë borgjeze dhe revizioniste janë përpjekur dhe vazhdojnë të përpilen që t'i mbushin mëndjen botës se gjoja Shqipëria nuk mund të ndërtohet, të rrojë e lirë dhe e pavarur me forcat, me punën dhe me vullnetin e hekurit të popullit të saj. Por gjithë këto gjenjeshtra janë demaskuar dhe po demaskohen njëra pas tjetrës nga vetë jeta. Popujt e botës po i shohin gjithnjë e më tepër me sytë e tyre fitoret që arrin populli ynë, ata po dëgjojnë me veshët e tyre zërin e fuqishëm të këtij populli kurdoherë në mbrojtje të së drejtës, në mbrojtje të socializmit, në mbrojtje të interesave të tij dhe të popujve të tjerë të botës. Ata po dëgjojnë me kënaqësi zërin e fuqishëm të revolucionit proletar, që do ta përmbysh nji ditë këngë themelë shoqërinë e vjetër borgjeze, kapitaliste, imperialiste, revizioniste.

Kapitalistët dhe revizionistët po gërthasin përfshirët e «ndjenja humanitarë» dhe «përfshirët e njeriut», por faktet tregojnë se në vendet ku sündojnë ata s'ka as humanizëm, as liri, atje mbretëron mjerimi përfshirullin, përfshirët e punëtore, përfshirët e fshatarësinë. Me miliona janë atje të papunët që vdesin nga sëmundjet e nga uria. Kudo ka greva, anarki, inflacion, kriminalitet, demonstrata, kudo ka probleme e shqetësimë të panumërtë përfshirët, që regjimet në fuqi nuk janë në gjëndje t'i zgjidhin. Në këto vende jeta e njeriut nuk është asnjëherë e sigurt.

Në vendin tonë socialist është e kundërtë, populli lufton, punon dhe rron i gëzuar. Cdo ditë e qdo vit jeta e tij përmirësohet. Këtu nuk ka papunësi, nuk ekzistojnë më taksat, nuk ngrihen çmimet, nuk ka inflacion, dhe të tilla nevoja jetësore si shërbimi shëndetësor e arsimi janë të siguruara falas. Qiratë e shtëpive te ne janë aq të vogla saqë gjetëkë është e vështirë ta besojnë këtë të vërtetë. Por faktet dhe realiteti ynë flasin vetë.

Këtë Shqipëri të bukur e të lulëzuar socialistë e ka ndërtuar populli i saj dhe jo të huajt, atë nuk e kanë ndërtuar as titistët jugosllavë, as revizionistët sovjetikë dhe as revizionistët kinezë. Imperializmi amerikan, vendet kapitaliste të botës, revizionistët sovjetikë, revizionistët kinezë dhe gjithë revizionistët e tjerë e kanë pasur vazhdimisht halë në sy vendin dhe regjimin tonë socialist. Të gjithë këta armiq janë përpjekur me një mijë mënyra të na dëmtonin, të na skillavëronin.

Por nuk skllavërohet aq lehtë një popull si yni, që e ka treguar trimërinë e tij në shkuj, që po e tregon atë edhe sot e do ta tregojë vazhdëmisht në cdo moment të jetës së vet me luftën e ashpër parimore, që bën bashkë me Partinë dhe pushtetin, për të demaksuar të gjithë ata që përpinqeshin e përpiken ta dëmtojnë.

Le të dalë ai shtet kapitalisto-revizonisto-imperialist që të mohojë këtë realitet të madh, ndërtimin e socializmit në vendin tonë, jetën e lumtur e të gjëzuar që po zhvillohet te ne, politikën e drejtë e të paravarur të shtetit shqiptar, miqësinë e madhe që ka shteti ynë i diktaturës së proletariatit me popujt e botës, dhe në mënyrë të veçantë me të gjithë ata popuj që luftojnë për çlirimin e tyre kombëtar dhe shoqëror.

Le të përpiken, në qoftë se do të mundin, shtetet kapitalisto-revizoniste ta errësojnë këtë fakt madhështor dhe të pamohueshëm që brenda disa muajve u rindërtuan në tërë Shqipërinë e Veriut të gjitha ato ndërtesa që u shkatërruan nga tërmeti. Kjo është një punë kolosale, një realitet i duhkshëm, që armiqëtë nuk mund ta mohojnë dhe ta errësojnë dot.

Bota kapitalisto-revizoniste është shprehur se politika jonë do ti nënshtrohej ndonjë fuqie të madhe dhe vendi ynë do të bëhej prëja e tyre. Por kjo as nuk ngjau dhe as nuk do të ngjasë kurrë. Një predikim i tillë dritëshkurtër nxori kokë që kur ne filluan luftën kundër revolucionistëve jugosllavë. E njëjtë histori u përsërit kur demaskuam me ashpërsinë më të madhe dhe me drejtësi revolucionare tradhtarët revolucionistë sovjetikë. Po kjo gjë ngjau edhe kur ne gjithashtu demaskuam revolucionistët kinezë dhe teorinë famëkeqe të maocedunidesë. Pritnin kapitalistët e ndryshëm ose revolucionistët sovjetikë që, pas prishjes me kinezët, ne të lidheshim me ta, pritnin ata që Shqipëria t'u nderte dorën dhe pastaj zverkun e të bëhej një koloni e tyre. Por koi kanë pritur, kjo kurrë nuk do të ngjiste dhe kurrë nuk do të ngjasë as në të ardhmen. Populli shqiptar nuk pranon zgjedhë e zinxhirë të çfarëdo lloji.

Popujt, njerëzit revolucionarë e përparimtarë, shokët tanë marksistë-leninistë, le të kenë besim të patundur se Shqipëria socialiste do ta mbajë kurdoherë lart e të papërlyer flamurin e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit. Josif Stalinit, këtij marksist-leninisti të lavdishëm, këtij revolucionari të madh proletar, që me përjashtim të armiqve të socializmit gjithë popujt dhe bota e përparuar e nderojnë dhe e respektojnë, ne këtë vit do ti festojmë me madhështi 100-vjetorin e lindjes.

Ne kemi mbajtur e do të mbajmë marrëdhënie normale shtetërore, tregtare dhe kulturore me të gjitha ato shtete me të cilat kemi marrëdhënie të tilla, si dhe me të tjera që do të dëshirojnë të kenë marrëdhënie të drejta me ne, me përjashtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Bashkimit Sovjetik revolucionist dhe të disa shtete të tjera, të cilat i kanë bërë dhe sot e kësaj ditë vazhdojnë t'i bëjnë padrejtësira Shqipërisë socialiste. Ne nuk do të kemi marrëdhënie as me ato shtete që, pa asnjë të drejtë, vazhdojnë të mos ia kthejnë

pasuritë e grabitura popullit shqiptar dhe të mos i paguajnë shpërbilimet për dëmet e shkaktuara nga Lufta e Dytë Botërore. Ky ka qenë kurdoherë vullneti i popullit tonë, i tillë është dhe i tillë do të jetë ky vullnet edhe në të ardhmen. Asnjë shpresë të mos ketë reaksiuni botëror për ndryshimin e qëndrimit tonë lidhur me këto kërkesa të ligjshme.

Populli ynë edhe kësaj radhe e tregoi qartë forcën e karakterit të tij luftarak e të pamposhtur, shpirtin e tij të paepur revolucionar, vendosmërinë e guximin e tij të pashembullt. Ai tregoi edhe një herë se ç'mundësi kolosale fsheh në gjirin e tij, ç'vëpra madhështore është në gjendje të realizojë, nën udhëheqjen e Partisë, me forcat e me vullnetin e tij të celikët, me mendjen e kthjellë dhe me duart e tij të arta. I madh e i vogël u ngriten në këmbë, u hodhën në sulm klasa jomë punëtore, fshatarësia kooperativiste, rinia, inteligjencia, ushtarëkët, të cilët, me shpejtësi të rrufeshme, dérguan vullnetarë dhe ndihma materiale në zonat e dëmtuara nga tërmeti. Të gjithë u gjendën menjëherë pranë vëllezërvë e motrave të tyre në këto momente fatkeqësie. Në këtë gatishmëri e mobilizim të lartë spikati edhe një herë ai solidaritet i imrekullueshëm socialist që ka kalitur Partia te njerëzit tanë, ai besim i patundur luftarak i popullit rrëth Partisë. Dihet botërisht nga të gjithë se të tëra këto nuk i ndërtuan as papa i Vatikanit, as fryma e shenjtë, as e ashtuquajtura zonja e papërlyeme, por i ndërtuan krahët e fortë dhe mendja e imprehtë e klasës punëtore dhe e punonjësve të tjerë të Shqipërisë. Popujt dhe njerëzit e varfér nuk i shpëtojnë nga vuajtjet dhe nga injerimet as lutjet e papës së Vatikanit, as gjenjeshtrat e Washingtonit dhe të Moskës dhe as ndërtimi i kambanareve të kishave e i minareve të xhamive. Është vetëm puna e njerëzve të gjiruar nga skllavëria kapitaliste që mund të bëjnë çudira. Vetëm lufta kundër reaksionit, kapitalizmit e revizionizmit është ajo që e shpëton njerëzimin. Vetëm socializmi, i ndërtuar sipas mësimave të Marksit e të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, është ai rend ekonomiko-shoqëror që, në cdo rast, cdo fatkeqësi e shndërron në forcë të madhe revolucionare që imposht cdo dhembje, që përballon cdo vështirësi dhe i bën njerëzit të luntur.

Ne, shqiptarët, rrojmë dhe do të rrojmë në miqësi me popujt e gjithë botës, dhe në mënyrë të veçantë me popujt fqinj. Na erdhi shumë keq që popullit fqinj të Malit të Zi dhe popullatës shqiptare që banon në këtë republikë u ngjau e njëjtë fatkeqësi e rëndë natyrore sikurse edhe neve. Dëshirojmë e shpresojmë që edhe në këtë vend iku ne, tok me partizanët jugosllavë, kemi derdhur gjakun në luftën çlirimtare nga pushtuesit nazi-fashistë, më parë nga cdo gjë të ndërtohen shtëpitë e rrënuara dhe kjo fatkeqësi të mos shkaktojë asnjë emigrim të njerëzve në vende të huaja.

Vellezër dhe motra,

Në emër të Komitetit Qëndror të Partisë dhe në emrin tim, përhëndes dhe përgëzoj nga zemra popullsinë e rrëtheve të dëmtuara nga tërmeti dhe vullnetarët nga të gjitha anët e Shqipërisë që, pa u kursyer

dhe pa ndierë çështë lodhja, derdhën djersën e tyre për të realizuar këtë vepër monumentale të Partisë; përshtendes dhe përgëzoj gjithë punonjësit e vendit tonë që, me një frymë të lartë revolucionare dhe me një disiplinë të çelikëtë proletare, duke qenë të ndërgjegjshëm për vështirësitë e krijuara dhe të frymëzuar nga ndjenja e lartë e patriotizmit socialist, përballuan me sukses detyrat e planit, duke zëvendësuar punën e mijëra shokëve të tyre vullnetarë që shkuan në ndihmë të zonave të dëmtuara nga tërmeti; përshtendes dhe përgëzoj gjithashut organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe ato të ekonomisë, shtabet për zhdukjen e pasojave të tërmetit, projektuesit e gjithë specialistët e tjerë për organizimin dhe drejtimin e mirë, për kurorëzimin me sukses të plotë të këtij aksioni të madh, që u bë një shkollë e vërtetë edukimi, kaliteje revolucionare dhe përvoje të pasur.

Pumëtorë e kooperativistë, të rinj, të reja e punonjës të tjerë në të gjithë Shqipërinë,

Sivjet do të festojmë jubileun e lavdishëm të 35-vjetorit të shkrimit të Atdheut e të fitores së revolucionit populor, prandaj për ndertë këtij jubileu, na vihet si detyrë e madhe dhe e vazhdueshme që të përveshiri llérët, të derdhim djersë, të vëmë të gjitha forcat e zemrës e të mendjes për të realizuar detyrat që na janë ngarkuar, qofshin këto detyra në fushën ekonomike, politike a të mbrojtjes. Të punojmë që ekonomia janë populllore vazhdimisht të përparojë e të fuqizohet, që fuqia janë mbrojtëse të rritet dhe Atdheu ynë socialist të bëhet i paprekshëm nga çdo armik. Asnjë shqiptar dhe shqiptare të mos harrojë se me punë e me luftë e krijuan këto mundësi për përmirësimin e jetës. Duhet të mendojmë për sot, por edhe përmesë, prandaj t'i tejkalojmë planet, të shtojmë rezervat dhe mbi çdo gjë të vërmë interesat e popullit, interesat e Atdheut socialist. Populli shqiptar me këtë synim duhet ta gjojkojë çdo punë që bën dhe çdo qëndrim politik që mban. Partia, populli dhe Atdheu socialist mbi të gjitha!

Këto fatkeqësi, që janë bërë për ne prova të mëdha të unitetit, të guximit, të trimërisë dhe të kalitjes revolucionare, ashtu si kurdoherë edhe në të ardhmen, poqe se na ngjasin, le t'i kthejmë në forca të pashtershme, t'i kthejmë në fitore. Dhembjet e mëdha që na shkatuan humbja e njerëzve tanë nga tërmeti i 15 prillit dhe humbja e parakohshme e shkotut tonë të lavdishëm, udhëheqësít të shquar të Partisë e të popullit tonë, luftëtarit trim e heroik të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit të socializmit, Hysni Kapos, që deri në çastin e fundit të jetës së tij foli dhe mendoi për Partinë dhe popullin e që pikërisht këtu në Bajçellëk, pak javë përparrë se të vdiste, vuri gurin e parë në themelët e këtij fshati socialist që po shfaqet përparrë syve tanë, t'i kthejmë në një forcë të madhe për ndërtimin e plotë të socializmit e për forcimim e mëtejshëm të mbrojtjes së Atdheut.

Të pavdekshme dhe të përjetshme qofshin për Partinë dhe për popullin tonë figura dhe puna e ndritur e militantit të madh Hysni Kapo!

Sukseset që kemi arritur le të na shërbijnë, të na nxitin e të na frymëzojnë që ta shtojmë gjithnjë e më shumë dashurinë për njërit-tjetrin, që të shtojmë dashurinë për Partinë tonë të madhe, që na udhë-

heq me aq urtësi, me aq guxim e me aq trimëri nga fitorja në fitore në të gjitha fushat. Të vëmë plotësisht në jetë amanetet e mijëra shokëve tanë të rënë në Luftën Nacionallçlirimtare dhe të shumë të tjerëve që ranë në punë e në luftë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e Atdheut; të ruajmë kujtimin e dëshmorëve të kombit, të cilët luftuan për këto ditë kaq të lumtur që po kalon Atdheu ynë i fortë socialist, Atdheu ynë i lumtur dhe i lulëzuar.

Me këtë rast, gjithashut, në emër të Komitetit Qendror dhe në emrin tim, dëshiroj të uroj nga zemra popullin e rrëhit të Shkodrës, të cilin Presidiumi i Kuvendit Popullor, me propozimin e Byrosë Politike, i dha urdhrrin më të lartë: «Hero i Punës Socialiste». Shkodra historike, Shkodra e luftëtarëve të shquar të pushkës e të penës, të Rilindjes e të Pavarësisë Kombëtare, Shkodra e Luftës Nacionallçlirimtare, Shkodra e punës së palodhur për ndërtimin e socializmit, për realizimin e planeve ekonomike, kulturore dhe e veprave të mbrojtjes, e meriton plotësisht nderin e madh që i bën sot mbarë Atdheu ynë, Shqipëria.

Edhe një herë, vëllezër dhe motra të Shkodrës dhe të gjitha qyteteve e fshatrave që u rrënuan nga tërmeti i fortë i 15 Prillit, ju uroj t'i gjëzoni shtëpitë e reja, të kaloni në to një jetë të lumtur e të bukur me fëmijët tuaj, të cilët t'i rritim luftëtarë trima e besnikë të Partisë, t'i kalim e t'i bëjmë njerëz të vendosur, punëtorë dhe të thjeshtë, ashtu siç është vetë populli ynë. Të ndezim në zemrat e brezit të ri, me shembullin e popullit tonë të pavdekshëm, në shekuj, ndjenjat më të pastra të lirisë, të pavarësisë, të dashurisë për shoku-shokun dhe, në radhë të parë, të dashurisë së pakufishme për Partinë e Punës të Shqipërisë, për shtetin e diktaturës së proletariatit. T'i bëjmë fëmijët tanë internacionalistë të flaktë, që kur ta dojë nevoja të hidhen në zjarr për të mbrojtur kurdoherë kufijtë e Atdheut, revolucionin proletar dhe luftërat nacionalçlirimtare anti imperialiste.

Rroftë Partia!

Rroftë populli!

